

UDHËZIM
Nr.5, datë 4.10.2006

**PËR RREGULLAT QË DUHEN RESPEKTUAR PËR AFISHIMIN E MATERIALEVE
PROPAGANDISTIKE NË FUSHATË ZGJEDHORE**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbështetje të nenit 3 pika 7, nenit 5, nenit 29 pika 1, nenit 134 pika 1 dhe nenit 135 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

UDHËZON:

Parime të përgjithshme

Neni 1

Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë rregullat që duhen zbatuar për afishimin e materialeve propagandistike gjatë periudhës zgjedhore, për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore.

Neni 2

1. Organet e Qeverisjes Vendore janë të detyruara të caktojnë në mënyrë të drejtë dhe të paanshme vendet publike për afishimin e materialeve propagandistike zgjedhore.

2. Caktimi i vendeve për afishimin e materialeve propagandistike zgjedhore bëhet publik dhe u njoftohet partive politike jo më vonë se 10 ditë nga dalja e Dekretit të Presidentit, për caktimin e datës së zgjedhjeve,

Neni 3

Për qëllim të këtij udhëzimi partitë pjesëmarrëse në zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore, ndahen në parti parlamentare dhe parti joparlamentare.

Neni 4

Caktimi i vendeve të afishimit

1. Caktimi i vendeve publike për afishim realizohet duke përcaktuar vende, sipërfaqe dhe kohë afishimi të barabarta për secilën parti, brenda grupit ku bën pjesë.

2. Për partitë parlamentare vendi dhe sipërfaqja, për afishimin e materialeve propagandistike, është sa dyfishi i vendit dhe sipërfaqes që u caktohet partive joparlamentare.

3. Në caktimin e vendeve publike për afishimin e materialeve propagandistike Organet e Qeverisjes Vendore duhet të mbajnë parasysh:

- sheshet publike dhe afërsinë e tyre me qendrën e njësisë administrative përkatëse;
- rrugët kryesore;
- vendet e veçanta të caktuara për afishim;
- mundësinë e ndriçimit.

4. Ndalohet vendosja dhe afishimi i materialeve propagandistike zgjedhore në ndërtesat e institucioneve publike.

Neni 5

Respektimi i barazisë

Vënia në dispozicion e sipërfaqeve për afishimin e materialeve propagandistike, bëhet me të njëjtin çmim për sipërfaqe dhe kohë afishimi të barabartë.

Neni 6

Personat juridikë dhe fizikë

Personat juridikë apo fizikë që ushtrojnë aktivitet në fushën e reklamave në territorin e njësisë vendore përkatëse, janë të detyruar që të respektojnë parimet e barazisë ndërmjet subjekteve zgjedhore, në rastin kur afishojnë materiale propogandistike zgjedhore.

Neni 7
Kompensimi

1. Në rastet kur KZQV konstaton shkelje të dispozitave të këtij udhëzimi, me vendim urdhëron kompensimet përkatëse të cilat realizohen menjëherë.
2. Vendimi i KZQV i dërgohet menjëherë Organit të Qeverisjes Vendore përkatëse.

Neni 8
Sanksionet

Në rastet e kundërvajtjeve administrative, KQZ vendos sanksionet administrative të parashikuara në ligjin nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Neni 9

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Çlirim Gjata	Kryetar
Flamur Çato	Zv/Kryetari
Dëshira Subashi	Anetar
Klement Zguri	Anëtar
Arben Ristani	Anëtar
Fatmir Kumbaro	Anëtar